



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1256, datë 16.04. 2010**

**Për**

**Miratimin e Dokumentit “Rregullore per treguesit e cilesise se sherbimit”**

---

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e dates 06.04.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit **“Rregullore per treguesit e cilesise se sherbimit”**

.

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja o) dhe p) e Nenit 8, germa 3 e Nenit 98 dhe germa 2 e nenit 102 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

## **K Ë SH I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

### **V Ë R E N:**

1. Dokumentacioni për **“Rregullore për treguesit e cilesise se sherbimit”** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë:

- futjen e procedurave dhe sistemeve të informacionit që kanë të bëjnë me trajtimin e treguesve të cilesise se sherbimit,
- sigurimin e mekanizmave të pershtateshme të cilat lehtësojnë kontrollin e tyre nga AKEP, ose një njësi tjetër e angazhuar nga ky Autoritet,
- berjen të disponueshem për përdoruesit dhe AKEP informacionin mbi treguesit e cilesise se sherbimeve të ofruara, sipas ligjit dhe kesaj Rregulloreje;
- të realizojë zgjidhje që janë plotësisht në përputhje me legjislacionin aktual

bazuar në shkronjen o) dhe p) të Nenit 8, germen 3 të Nenit 98 dhe germen 2 të nenit 102, pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë **“Rregullore për treguesit e cilesise se sherbimit”**, sipas dokumentit bashkëlidhur
2. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit [www.akep.gov.al](http://www.akep.gov.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**